

TË BASHKUAR



PËR TË ARDHMEN

DEMOKRACIA SOT...

ARLOT (13), ERION (13), ETNA (13), ALKETA (13), ÇELTINA (13), BLERTA (14)



Demokracia është e shenjtë, prandaj duhet ta duam dhe të punojmë për të, që të shkojmë përpara dhe ta zhvillojmë vendin tonë!

Demokracia është njëra nga sistemet e udhëheqjes që po zhvillohet edhe në Kosovë. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull, dhe „kratos“ që do të thotë rend. Demokracia ndahet në demokraci të drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në demokraci presidenciale dhe parlamentare. Demokracia e drejtpërdrejtë është kur vendimet i marrin vetë qytetarët për vendin e vet si p.sh. përmes referendumeve dhe peticioneve. Demokracia për herë të parë është paraqitur në vitin 507 para erës sonë, kjo do të thotë se është formuar në vitet shumë të hershme rreth 26 shekuj më herët. Në vendin tonë, në Kosovë kemi rreth 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë shqiptarë, kurse 20 prej tyre janë të komunitetit jo shumicë.

Demokracia më herët është shkelur mizorisht, ku shtresa e të pasurve ka sunduar, ndërsa shtresa e të varfërve nuk e kanë pasur fare këtë të drejtë dhe punonin për shtresat e të pasurve.

Në demokraci të drejtat e njeriut mbrohen me ligj. Çdo njeri ka të drejtat e veta. Të drejtat e çdo njeriu janë të barabarta.

Së bashku me shoqërinë time ishim në qytet. Duke ecur takuam njerëz që dëshironin që demokracia të ishte në nivel më të lartë. Për këtë vendosëm të bënim

diçka sado pak të vogël. Të nesërmen së bashku me shoqërinë time, vendosëm të bashkangjitemi me të tjerët për demokracinë. Pasi i morëm disa fletushka, secilit person në rrugë ia dhamë ato, duke i njoftuar ata për demokracinë. Sipas interesimit dhe buzëqeshjes së tyre, rezultati pritet të zhvillohet shpejt.

Andaj, ju njerëz, e dini çka është demokracia?

Demokracia është kur ne qytetarët vendosim për vendin tonë, prandaj vëreni guximin ta mposht forcën. Jeta është e mirë me gjërat që i ka. Të punojmë për ato gjëra që sot i kemi, para se njerëzit të qeverisin në atë mënyrë që është e padrejtë për qytetarët e vendit tonë. Qytetarë, demokracia sot është njëra ndër gjërat e rëndësishme. Demokracia ju ndihmon që të arrini gjërat që i dëshironi, prandaj mos e humbisni atë!



Ne punojmë për demokraci të mirëfilltë




Në demokraci të gjithë jemi të barabartë. Mirëpo, ne kemi përgjegjësi të jemi aktiv për të mirën e vendit tonë.



Liria, barazia, drejtësia dhe paqja janë disa nga elementet e demokracisë



Të lumtur në demokraci, sepse gëzojmë të drejta dhe mund të shprehemi lirshëm



Demokracia ndahet në dy lloje: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese

SË BASHKU PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRË

ERJONA (13), ALKETA (13), ANITA (14), EDA (13), RINESA (13), ARNITI (14)

Ti i duhesh këtij vendi, andaj bëhu qytetar aktiv!

Çka kuptojmë me fjalën qytetar?

Çdo individ ose person i cili gjendet në një shtet dhe ka leje qëndrimi në atë vend e quajmë qytetar të atij vendi. Ne si qytetar të një vendi demokratik kemi të drejta dhe përgjegjësi.

Disa nga të drejtat tona janë: e drejta për shkollim, e drejta e të shprehurit lirshëm, e drejta e identitetit, etj.

Ndërkaq, përgjegjësi e jona është ta ruajmë ambientin, ta respektojmë ligjin dhe njëri-tjetrin, të mos kemi diskriminime ndaj njëri-tjetrit. Pjesëmarrja në OJQ, iniciativat për vetëdijësim, protestat si dhe pjesëmarrja në shoqata të ndryshme të shquajnë si qytetar aktiv. Porosia jonë është: bëhu qytetar aktiv dhe ndihmo për zhvillimin e vendit tënd.



Të mos i diskriminojmë fëmijët



Ne si qytetarë aktiv që jemi



Unë si qytetare, kam të drejta por edhe përgjegjësi



Ne jemi të barabartë dhe mund të mbrohemi



E drejtë e jona është arsimimi dhe edukimi



T'i respektojmë të drejtat e njëri-tjetrit

PUSHTETI NË KOSOVË

NART (13), OLSA (13), DREN (13), LEJLA (13), RION (13), KALTRINA (14)



Qeverisja dhe institucionet e saj

Ne jetojmë në një vend ku kemi shumë të drejta, dhe këto të drejta na mundësohen nga vetë sistemi demokratik. Sistemin demokratik e kuptojmë si një formë të qeverisjes nga vetë populli. Nëse ne do të jetonim në një vend ku demokracia nuk do të ishte formë e qeverisjes në atë vend, atëherë do të shkeleshin shumica e të drejtave tona. Prandaj, ne e kuptojmë demokracinë si forma më e mirë e qeverisjes, sepse na sjell shumë të drejta dhe mundësi të shumta për një jetë sa më të mirë.

Në vendin tonë, sistemi qeverisës është demokratik parlamentar. Aty bëjnë pjesë institucione të shumta duke përfshirë Kuvendin, Qeverinë dhe gjykatat. Pushteti në Kosovë iu ndahet këtyre institucioneve.

Roli i Kuvendit është formimi i ligjeve dhe miratimi i tyre. Në Kuvend ka 120 deputetë, ku prej tyre 100 janë qytetarë shumicë dhe 20 janë të komuniteteve joshumicë të cilat janë: serb, turq, romë, egjiptian, goran, boshnjakë, etj. Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi ka edhe funksionin kontrollues dhe përfaqësues.


Funksioni kontrollues ka rol të rëndësishëm, sepse kontrollon Qeverinë, kurse ai përfaqësues, sepse përfaqëson vet popullin.

Qeveria ka Pushtet Ekzekutiv, sepse propozon dhe i zbaton ligjet kur ato miratohen nga Kuvendi.

Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, zv.kryeministrat, ministrat dhe zv.ministrat.

Gjykatat janë institucione ligjore, të cilat merren me drejtësinë e vendit. Në çdo vend demokratik ka ligje të cilat janë rregulla dhe zbatohen nga qytetarët. Nëse ne nuk e respektojmë ligjin dhe e thyejmë atë, atëherë çështja do të shqyrtohet në gjykatë. Gjykata ndahet në: Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme.

Këto institucione punojnë në mënyrë të pavarur, mirëpo kanë të përbashkët mirëqenien e popullit.



Grupi i demokratëve



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë